



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1045/1 prot.

Tiranë, më 07. 08. 2020

V E N D I M

Nr. 80, datë 07. 08. 2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 79, datë 21.07.2020, të J. B., ku pretendohet diskriminim për shkak të *“gjendjes shëndetësore, përkatësisë në një grup të veçantë”* dhe *“për çdo shkak tjetër”*, nga ana e Bankës CREDINS.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, shtetasi J. B. në ankesën e sjellë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) pretendon se është diskriminuar nga ana e punëdhënësit të tij, Banka Credins sh.a., duke nisur që nga fillimi i vitit 2018, deri në largimin e tij nga puna. Mbështetur në aktet e vëna në dispozicion bashkëngjitur ankesës, J. B. pretendon se në 4 vite punë pranë Bankës Credins, ka qënë i vetmi punonjës me vjetërsinë më të madhe në sektor dhe është trajtuar ndryshe nga kolegët e tij, duke u paguar 35-55% më pak se të tjetët. Vazhdimisht nga ana e punëdhënësit është akuzuar për mospërmbyllje të objektivave, pirje alkoli në orarin e punës, thyerje të Kodit të Etikës dhe veshje e papërshtatshme në punë.

Referuar provave të vëna në dispozicion nga ana e ankuesit, problematika ndërmjet tij dhe punëdhënësit, kishte nisur në muajin Gusht të vitit 2017, kur ankuesi ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë me kolegët e tij, lidhur me përfitimin e pagesës së dietave ditore, për shërbime të kryera jashtë qendrës së punës. Më pas, më datë 07.06.2019, ankuesi së bashku me disa kolegë të zyrës, kanë themeluar Sindikatën e Punonjësve të Institucioneve Bankare dhe Institucioneve Jo Bank. Mbështetur në votimin e anëtarëve të Sindikatës, ankuesi është zgjedhur Kryetar i saj. Në vijim, sipas legjislacionit përkatës, kanë nisur procedurat dhe kanë depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, kërkesën për rregjistrimin e Sindikatës së Punonjësve të Institucioneve Bankare dhe Institucioneve Jo Bank (procedura e njohjes nga gjykata është ende në proces).

Sipas ankuesit, sapo punëdhënësi është informuar rreth krijimit të Sindikatës dhe zgjedhjes së tij në cilësinë e kryetarit, ka nisur procedurat për largimin e tij nga puna. Më datë 26.06.2019, është vënë në dijeni nga ana e punëdhënësit, lidhur me shkresën Nr. 36096 prot., datë 26.06.2019, lidhur me zhvillimin e takimin përsa i përket vijimit të marrëdhënieve të punës. Në kushtet që ankuesi, si pasojë e gjendjes shëndetësore, nuk e ka patur të mundur të paraqitet në takimin e caktuar, atëherë nga ana e punëdhënësit, është shtyrë procedura deri në rikthimin e tij në detyrë, në muajin nëntor 2019.

Më datë 20.11.2019, pasi ankuesi është kthyer në vendin e punës, është njoftuar për takim në të njëjtën ditë dhe janë zgjidhur marrëdhëniet e punës, për shkak të paraqitjes me vonesë në punë në 38 raste dhe përdorimit të veshjes jo etike në orarin e punës.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e Bankës Credins sh.a., për shkaqet sipërcituara, si dhe marrjen e masave për rregullimin e situatës duke e rithyer në gjendjen e mëparshme.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Neni 1 i Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Referuar informacionit të dhënë në ankesën, drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, J. B., ka paraqitur më datë 14 korrik 2020, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesë padinë me objekt:

- Konstatimin e zgjidhjes së Kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme,
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin J. B. në masën e 12 pagave mujore për zgjidhjen e kontratës pa shkaqe të arsyeshme, bazuar në nenin 146 të Kodit të Punës...

Mbështetur në Kërkesë padinë e sipërcituar, depozituar pranë KMD-së nga ana J. B., rezulton se ai ka ngritur të njëjtat pretendime të paraqitura pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Më saktësisht, në faqen 3 të kërkesë padisë, ndër të tjera subjekti ankues pretendon se: *“...Punëdhënësi kishte disa kohë që përpiquej të gjente shkaqe për të më larguar nga puna dhe mendoj se një nga shkaqet ka qënë fakti se unë më datën 07.06.2019, ka themeluar një Sindikatë...Si për çudi pas 19 ditësh ndaj meje fillon procedura për largimin tim nga puna...”*

Pra, nga sa rezulton i cituar edhe më sipër (në kërkesë padi), duke ju referuar nenit 146, të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*, në të cilin sanksionohet ndër të tjera se:

“1. Zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi, konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme kur:

a) punëmarrësi ka pretendime që rrjedhin nga kontrata e punës;

b) punëmarrësi ka përmbushur një detyrim ligjor;

c) shkel ndalimin e diskriminimit, sipas përcaktimeve në këtë Kod dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.

d) për motive që lidhen me ushtrimin nga punëmarrësi, të një të drejte kushtetuese, por që nuk sjell shkeljen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e punës;

e) bëhet për motive të antarësimit ose jo të punëmarrësit në sindikatë të krijuar në bazë të ligjit ose për shkak të pjesëmarrjes së tij në veprimtari sindikale në bazë të ligjit;...”, pjesë e arsytimit është bërë dhe largimi nga puna për shkak të diskriminimit dhe anëtarësimit në Sindikatën e Punonjësve të Institucioneve Bankare dhe Institucioneve Jo Bank.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, ndër të tjera citohet: *“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai*

mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesës përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Në kushtet që kërkesa e paraqitur nga J. B. është bërë objekt gjykimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe në mbështetje të paragrafit 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet: *“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën Nr. 79, datë 21.07.2020, të shtetasit J. B. kundër Bankës Credins sh.a.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet shprehimisht se: *“Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 36 të Ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 21, pika 1, nenit 32, pika 1, germa a), nenit 33, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 10, si dhe nenit 36, pika 3, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me Nr. 79, datë 21.07.2020, të shtetasit J. B.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja shëndetësore, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër)
(Fusha: Punësim)